



Datë: 07.04.2025

Numër Protokolli: 2303/2025

A.nr.351/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Sabile Avdyli, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.351/2025, të datës 24.02.2025, të parashtruar nga ankuesja M.K., kundër organit të punësimit/Komuna e Klinës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 07.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. *Aprovohet si e bazuar* ankesa me numër A.nr.351/2025, e datës 24.02.2025, e parashtruar nga ankuesja M.K.

II. *Anulohet* Njoftimi për kandidatët fitues me nr.111-2824/25 i datës 28.01.2025 i shpallur nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës, si dhe çdo veprim tjetër administrativ i ndërmarr në fazën e verifikimit paraprak dhe në fazën e vlerësimit profesional, lidhur me procedurën e pranimit sipas konkursit me numër reference RN00015977 për grupin “Grupi i shkencave shoqërore”, pozita e punës Zyrtar i lartë për integritet evropiane., klasa e pozitës Profesional 1, një pozitë.

III. *Mbetët në fuqi* akti i shpalljes së konkursit me numër reference RN00015977, për grupin “Grupi i shkencave shoqërore”, pozita e punës Zyrtar për Integritet Evropiane, ***ndërsa, çështja kthehet*** në fazën e vlerësimit të aplikacioneve.

IV. *Obligohet* Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrë të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi siç përcaktohet në pikën II dhe III të dispozitivit.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Ar sy et im

Kandidatja për pranim në shërbimin civil M.K, (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), më datë 21.02.2025 përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar më datë 24.02.2025, kundër Njoftimi për kandidatët fitues me nr.111-2824/25 i datës 28.01.2024 i shpallur nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës, lidhur me konkursin me numër reference RN00015977 për pozitën Zyrtar i lartë për integritet evropiane, në Komunën e Klinës, klasa e pozitës Profesional 1, Koeficienti GJ-5.62, 1 pozitë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 06.03.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Klinës, ndërsa kjo e fundit me datë 10.03.2025 ka përcjellë përgjigje në ankesë bashkë me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 1181/2024 të datës 24.02.2025 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopja e letërnjoftimit; Kopja e konkursit e datës 06.12.2024 me numër reference RN00015977; Emailin e datës 13.01.2025 –njoftim për testin me shkrim; Njoftimi për vlerësimin e testit me shkrim i datës 22.01.2025; Emailin e datës 27.01.2024 për rezultatet e intervistës me gojë; Njoftimi për kandidatët fitues me nr.111-2824/25 i datës 28.01.2025 i shpallur nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës; Rënditja përfundimtare e kandidatëve e datës 27.01.2025; Formularët e vlerësimit individual të anëtarëve të Komisionit të vlerësimit të datës 27.01.2024; Kërkesa për përgjigje e datës 06.03.2025; Përgjigje në ankesë e datës 10.03.2025 nga organi i punësimit; Lista e aplikantëve; Lista e kandidatëve të aprovuar; Lista e kandidatëve të refuzuar; Njoftimi i datës 08.01.2025 për verifikimin paraprak; Rënditja përfundimtare e kandidatëve e datës 27.01.2025; Vendimi me nr.112-43410/24 të datës 26.12.2024 për themelimin e komisionit të pranimit; Akt Emërimi i datës 02.08.2024 për E.M; Vendimi për caktimin e ushtruesit të detyrës i datës 06.09.2024 për K.Rr; Akt Emërimi i datës 17.12.2024 për A.Z; Akt Emërimi i datës 02.09.2024 për H.A; Akt Emërimi i datës 30.08.2024 për A.B; Aplikacioni i datës 19.12.2024 për kandidatin M.D bashkë me dokumentacionin e kërkuar; Aplikacioni i datës 27.12.2024 për M.K bashkë me dokumentet e kërkuara dhe Formularët e vlerësimit të kandidatëve nga anëtarët e Komisionit të datës 27.01.2025.

Duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, Kolegji i Këshillit ka gjetur se pretendimet ankimore të ankuses janë të bazuara, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë se Komuna e Klinës, më datë 06.12.2024, ka shpallë Konkursin me numër reference RN00015977, për grupin “Grupi i shkencave shoqërore, pozita -Zyrtar për integritet evropiane, klasa e pozitës Profesional 1, për një pozitë, ndërsa afati për aplikim ka qenë nga data 07.12.2024 deri më 05.01.2025, dhe ku sipas pikës 3 të konkursit, si kërkesa e përgjithshme për këtë pozitë të punës janë përcaktuar: **Arsimimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë(Bachelor), Drejtimi –Juridik, Ekonomik(pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori,**

Shkenca Politike, Psikologji, Punë Sociale, Gjeografi, Administratë Publike. Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy(2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

Me tej, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë pesëmbëdhjetë (15) kandidatë, prej tyre kriteret e konkursit i kanë plotësuar dhe kanë hyrë në listën e ngushtë tetë (8) kandidatë, duke përfshirë këtu edhe ankuesen, e cila ka marrë pjesë në testin me shkrim, ka marrë gjithsejtë 62.4 pikë dhe intervistën me gojë ka marrë 25.2 pikë me gjithsejtë 87.6 pikë, ndërsa kandidati fitues në testin me shkrim ka marrë gjithsejtë 66.pikë dhe 29.4 pikë në intervistën me gojë, duke u renditur i pari në listën përfundimtare të vlerësimit të kandidatëve, me gjithsejtë 95.40 pikë të arritura.

Sipas aktit të shpalljes së rezultateve përfundimtare të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Klinës , të datës 28.01.2025, si kandidat fitues për pozitën Zyrtar për integritet evropiane, është shpallur kandidati M.E. me gjithsejtë 95.40 pikë.

Tutje, ankuesja e pakënaqur me procedurën e rekrutimit, me datë 24.02.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mbi pretendimet ankimore se procedura e konkursit është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Në kontest të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, e në mbështetje të nenit 86 të Ligjit për Procedurës së Përgjithshme Administrative, Kolegji ka analizuar dosjen e ankueses , dhe si rrjedhojë ka konstatuar se kandidata M.K, nuk i ka plotësuar kërkesat e përgjithshme formale të konkursit siç parashihet në pikën 3 të konkursit: Arsimimi dhe përvoja e punës. Nga provat e shqyrtuara Kolegji ka konstatuar se e njëjta posedon Diplomën e datës 13.07.2024 me nr.1130/24 të lëshuar nga Kolegji AAB me të cilën dëshmohet se e njëjta ka mbaruar studimet më datë 06.07.2024 dhe fitoi gradën Bachelor i Arteve në Administratë Publike dhe me këtë përvojë të punës: Vërtetimin e datës 02.07.2020 të lëshuar nga Zyra e Personelit në Komunën e Klinës me të cilin vërtetohet se e njëjta sistemohet në pozitën e punës Ofiqare nga data 22.07.2002 në Drejtorinë e Administratës pra ankuesja është në marrëdhënie pune në Komunën e Klinës që nga viti 2002 ku vazhdon edhe tani në pozitën Zyrtare e gjendjes civile, mirëpo deri më datën 13.07.2024 ka qenë me përgatitje të mesme shkollore, andaj e njëjta nuk e ka as një vit të përvojës profesionale, ndërsa kriteret e konkursit janë: **Arsimimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë(Bachelor), Drejtimi–Juridik, Ekonomik(pa specifikim),Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkenca Politike, Psikologji, Punë Sociale, Gjeografi, Administratë Publike. Përvoja e punës e kërkuar: Së paku një(2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.** Lidhur me përcaktimin se cila përvojë pune llogaritet përvojë pune profesionale, Kolegji Këshillit iu referua praktikës vendimmarrëse dhe të konfirmuar edhe sipas Aktgjykimit A.nr.2276/2014 të datës 24.05.2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimit A.nr.729/16 të datës 04.05.2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimit AA.nr.367/18 të datës 19.12.2018 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimit ARJ-UZVP.nr.77/2019 të Gjykatës Supreme të Kosovës, ku përmes këtyre aktgjykimeve konstatohet se në rastet kur kërkohet përvojë pune profesionale, përvoja e punës së kërkuar duhet të jetë pas diplomimit.

Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Klinës, nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen e fakteve më rastin e vlerësimit të aplikacioneve të kandidatëve për këtë pozitë të punës, për faktin se në listën e ngushtë ka përfshirë kandidatin znj.M.K. e cila nuk i ka dy(2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës., duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 39 paragrafi 7 nën paragrafi 7.1 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrarët Publikë ku përcaktohet se: *7....Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit;... si dhe në kundërshtim me nenin 7 të Rregullores Rregullore (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil ku shprehimisht është paraparë se: Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim në shërbimin civil plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga NjMBNj, më së largu pesëmbëdhjetë (15) ditë pas kalimit të afatit për pranimin e aplikacioneve, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit. 3.NjMBNj publikon në SIMBNj dhe uebfaqen e institucionit listën e kandidatëve të cilët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato specifike. 4. NjMBNj njofton kandidatët që nuk plotësojnë kushtet për rekrutim, duke përfshirë të gjitha kriteret dhe/ose dëshmitë e pa përmbushura jo më vonë se tre (3) ditë kalendarike nga data e publikimit të rezultateve”.*

Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit të aplikacioneve ka konstatuar se Kandidati fitues M.D. i cili bazuar në njoftimin e datës 28.01.2025 është kandidati më i suksesshëm me gjithsejtë 95 pikë, i njëjti posedon Diplomën e datës 04.11.2014 me Nr.3599 të lëshuar nga Fakulteti Filozofik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe mori titullin Bachelor i Shkencave Politike dhe me këtë përvojë pune: Vërtetimin e datës 31.12.2017 me të cilin vërtetohet se i njëjti nga data 13.05.2017 deri më 31.12.2017ka punuar në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në pozitën Zyrtar i Informimit Publik; bazuar në vërtetimin e datës 12.12.2024 të lëshuar nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës me të cilin vërtetohet se i njëjti prej datës 01.03.2019 deri më dt.23.07.2021ka punuar në pozitën Zyrtar për marrëdhënie me publikun, pranë zyrës së Kryetarit të Komunës së Klinës, dhe prej datës 03.04.2023 është emëruar Këshilltar i Kryetarit të Komunës ku vazhdon edhe tani dhe sipas vërtetimit të datës 17.12.2024 kandidati M.D. ka punuar në pozitën Sekretar i SHFMU "Esad Mekuli" në Carravik, Komuna e Klinës.

Kolegji i Këshillit, gjatë shqyrtimit të pretendimit ankimor të ankueses e cila konteston Vendimin me nr.112-43410/24 të datës 26.12.2024 për themelimin e komisionit për vlerësim nga Kryetari i Komunës së Klinës sepse Ky vendim është në kundërshtim me nenin 40 paragrafi 2, nën paragrafi 2.3 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publik të kësaj procedurë, ka vërejtur se sipas Vendimit me Nr. 02-035/02-1431 të datës 04.12.2024 është emëruar Komisioni i Pranimit për Kategorisë profesionale respektivisht për këtë grup ku sipas shqyrtimit të pozitave të anëtarëve të Komisionit të Pranimit, Kolegji konstaton se në komision janë tri pozita të kategorisë së ulët drejtuese dhe një pozitë e kategorisë profesionale dhe një pozitë nga Njëjësia e Burimeve Njerëzore. Në bazë të përbërjes së këtij komisioni, Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni i Pranimit ka qenë i themeluar në kundërshtim me nenin 20 paragrafi 2 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, është përcaktuar se: *“2. Komisioni i pranimit ka pesë (5) anëtarë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas pozitës për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësues nga NjMBNj; dhe 2.3. një (1) nëpunës i kategorisë*

profesionale i fushës përkatëse”, ngase sipas pozitive të anëtarëve të Komisionit të Pranimit rezulton se asnjë anëtar i këtij komisioni nuk është i specializuar në fushën përkatëse sipas pozitës për të cilin zhvillohet konkurrimi.

Kështu që, për sa me sipër dhe më qëllim të kthimit të ligjshmërisë lidhur me këtë procedurë të rekrutimit, Kolegji i Këshillit vendosi për aprovimin e ankesës si të bazuar, anulimin e Njoftimit për kandidatët fitues me nr.111-2824/25 i datës 28.01.2025 i shpallur nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës Aktit të datës 28.01.2025 për shpalljen e rezultatit përfundimtar si dhe çdo veprim tjetër administrativ i ndërmarr në fazën e verifikimit paraprak dhe në fazën e vlerësimit profesional. Ndërsa, meqenëse konkursi nuk është përfshirë me shkelje ligjore, Kolegji la në fuqi të njëjtin, ***ndërsa çështja kthehet*** në fazën e vlerësimit të aplikacioneve, rrjedhimisht obligohet Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, të bëjë rivlerësimin e aplikacioneve të kandidateve që kanë aplikuar për këtë pozitë të punës dhe në listën e ngushtë të përfshihen vetëm kandidatet që plotësojnë kushtet formale sipas konkursit.

Thënë si me sipër, e duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.351/2025

Sabile Avdyli

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, M.K.;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.